# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446149**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Prof. Dine Abazi, ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/ndahet-nga-jeta-ne-moshen-88-vjecare-prof-dine-abazi-ish-presidenti-i-i104225` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 13:19:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 13:08:04 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e209b2766544ec1afc5955d6f04f407904150ecd6b7a6b6cd95a61ff41e44747` |
| TEKSTI | `dda2ee954e18fbdc11ca25fdcc91805e189af6b23bbcb7846b56fe3ae5361cad` |
| PAMJA | `181564ff52a13552caaf2f8589fc7ac8355d6101ee87d2f4ff1d84a384bd84b7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `dd51d7323eb4f7ffd73ab0f7379815343fd64b0706ff392064122a405e46700a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/dd51d7323eb4f7ffd73ab0f7379815343fd64b0706ff392064122a405e46700a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Prof. Dine Abazi, ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 15:08



Ndahet nga jeta në moshën 88-vjeçare Prof. Dine Abazi, mjeku dhe ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë. Një prej figurave të njohura të komunitetit mjekësor shqiptar, Dine Abazi, për vite me radhë kontribuoi në sistemin shëndetësor dhe në përfaqësimin e profesionistëve të mjekësisë.

Ndarja e tij nga jeta përbën një humbje për familjen, kolegët dhe komunitetin e mjekëve shqiptarë. Redaksia e BalkanWeb u shpreh ngushëllimet familjarëve, të afërmve dhe kolegëve të Prof. Dine Abazit.

**Kush ishte mjeku Dine Abazi**
Prof. Dine Abazi ka qenë mjek dhe drejtues i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë; në vitin 2015 përfundoi mandatin si president, pas dy mandatesh radhazi.

Dokumentet e OKB-së e listojnë Dine Abazin si këshilltar (Conseiller) në delegacionin shqiptar në një konferencë ndërkombëtare. Në vitet 2014–2015, në cilësinë e drejtuesit të Urdhrit të Mjekëve, ai u shpreh publikisht për çështje të sistemit shëndetësor dhe testimin e mjekeve.

Lindur në një familje fshatare të varfër. Të parët e tij janë dalluar për atdhedashuri, trimëri dhe bujari. Babai, Ahmeti dhe vëllezërit e tij Beka, Ibrahimi dhe Mustafa kanë marrë pjesë aktive në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, kurse xhaxhai Xhemalji është vrarë në luftë për çlirimin e Gjakovës dhe është shpallur dëshmor i atdheut. Edhe Dini i edukuar në këtë vatër familjare është karakterizuar nga dashuria për njerëzit, thjeshtësia, zgjuarsia, ndershmëria dhe dëshira për dituri.

Në vitin 1967 u diplomua në mjekësi, mjek i përgjithshëm dhe u caktua mjek ushtarak në Degën e Punëve të Brendshme Ersekë. Për aftësi të mira profesionale caktohet në vitin 1971 në poliklinikën speciale të udhëheqjes së Partisë së Punës së Shqipërisë në Tiranë.

Në vitin 1987 dhe deri në vitin 1992 ka qenë drejtor i kësaj poliklinike i specializuar kardiolog dhe nga viti 1992 e deri në vitin 1997 ka shërbyer mjek kardiolog në poliklinikën nr. 3 Tiranë. Kurse nga viti 1997-1998 zv. ministër i shëndetësisë.

Që nga viti 1999 dhe deri në vitin 2005 kryen detyrën e Presidentit të Këshillit Kombëtar të mjekëve të Shqipërisë. Kudo ku ka punuar Dini ka qenë njeri i respektuar nga të gjithë ata shokë pune dhe jashtë saj, jo vetëm si mjek por edhe si njeri shumë i sjellshëm me njerëzit e të gjitha moshave apo shtresave të ndryshme të shoqërisë. Është njeri shumë i qetë, gjakftohtë, shumë i lidhur me punën dhe njerëzit. Figura e tij është e mbetet model pune e sjellje për të gjithë.

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 15 Shtator14:35

**Tentuan të vidhnin një motor, policia zë “mat” dy hajdutët dhe i vë në pranga**

Dy shtetas grekë janë arrestuar nga policia në Athinë, pasi u kapën në flagrancë teksa dyshohet se po tentonin të vidh...

AKTUALITET 15 Shtator14:03

**“Marr armë nga Sudani”/ Çfarë fshihet pas përgjimit të Ron Yeffet?**

Audio-përgjimi i Ron Yeffet i publikuar nga ish-zv/kryeministri Arben Ahmetaj ka nxjerr në pah një skandal në Shqipëri se si janë...

AKTUALITET 15 Shtator13:41

**Rrëfehet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më çoi në ferra dhe më përdhunoi! E kam takuar deputeten!**

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashk&e...

AKTUALITET 15 Shtator13:27

**80 bimë kanabisi afër tokës së tij, arrestohet 41-vjeçari në Mallakastër**

Një 41-vjeçar është arrestuar në Mallakastër, pasi dyshohet se kishte kultivuar bimë narkotike n...

Piranjat News AKTUALITET 15 Shtator12:44

**VIDEO/ “Ku ka qiell e tokë, aty jam unë”/ Lulzim Caka udhëtonte lirisht në Zvicër dhe sfidonte policinë**

“Piranjat News” kanë zbuluar se Lulzim Caka fshihej me dy identitete, duke përdorur emrin e rremë “Pepe”. Ai përdo...

AKTUALITET 15 Shtator12:37

**Apeli i GJKKO lë në burg Ilir Metën**

Ish-presidenti Ilir Meta do të vijojë të qëndrojë në burg, pasi GJKKO ka rrëzuar kërkesën e tij për ndryshim...

AKTUALITET 15 Shtator12:10

**Çmimet e larta nuk frenojnë kërkesën, rriten shitjet e karburanteve**

Çmimet e larta të karburanteve nuk kanë sjellë ulje të konsumit të naftës në tregun vendas. Në tremujorin e dyt...

AKTUALITET 15 Shtator11:57

**Trafikonin sasi të mëdha kokaine/ Goditet banda shqiptare në Belgjikë, arrestohet dhe Gert Gjenerali**

Policia belge ka arrestuar tetë persona në kuadër të një hetimi për një rrjet ndërkombëtar të trafikut t&eum...

AKTUALITET 15 Shtator11:28

**AMP arreston oficerin e Policisë në Durrës, procedohen dy të tjerë**

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka finalizuar më 15 shtator 2026 një operacion që çoi në arrestimin në flagranc&eum...

AKTUALITET 15 Shtator11:16

**Shpërthim me tritol në oborrin e një banese në Shijak**

Një shpërthim me lëndë plasëse është regjistruar gjatë orëve të para të mëngjesit në fshatin ...

## ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

**FOTO- ‘Mos u kthe më në Shqipëri’/ Edi Rama sul...**

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

**EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...**

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

BOTA 14 Shtator

**[“E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite”/ Bash...]**

Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]**

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video



## Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**






**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.